SHOQATA E AFARISTËVE SHARRI BUSINESS ASSOCIATION



# PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE



2022

EXPO SHARRI

PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA




DRAGASH, 2022



Sharri edhe pse vend i vogël në një cep të Kosovës qysh nga kohët e lashta njihet për ndërmarrës të mëdhenj të cilët kanë ditur të menaxhojmë kope dhensh të përbëra me mija dele.
Që nga kohët e lashta në këtë trevë është prodhuar djathi, mishi dhe ëmbëlsirat e cilësisë së lartë dhe kanë arritur famë ndërkombëtare.
Këtë trashëgimi edhe sot e kësaj dite e e kultivon kjo trevë e cila me ndërmarrës të rinj e ka zgjeruar fushën e veprimtarisë dhe nuk është që merret më vetëm me blegtori dhe me prodhime bujqësore, por ka dhe degë të ndryshme të industrisë të cilat me cilësinë e vetë po arrijnë të konkurrojnë në tregun lokal, vendor po ka dhe të atillë që eksportojnë drejtë Evropës dhe Botës.
Kjo më së miri u pasqyrua në panairin EXPO SHARRI 2022!
Të gjithë ata që kanë pas rast ta vizitojnë këtë panair, do të kishin vërejtur se sa i begatë dhe i llojllojshëm ka qenë, sa firma të qëndrueshme me prodhime të cilësisë shumë të lartë kanë marr pjesë, në të gjitha aspektet ky panair ka qenë i një niveli shumë të lartë.
Ajo që ka qenë dekor i kësaj ngjarjeje që lirisht mund të themi është ngjarja më e mirë ekonomike e organizuar në Sharr që nga mbarimi i luftës, kanë qenë vizitorët e shumtë.
Kemi qenë të nderuar me praninë e Kryeminstrit të Republikës së Kosovës z. Albin Kurti dhe të Kryetarit të komunës së Sharrit z. Bexhet Xheladini të cilët njëherë edhe e kanë bërë prerjen e shiritit në hapjen e panairit.
Kjo ngjarje nuk do të mund të realizohej pa mbështetjen e Kuvendit Komunal Dragash që i falënderojmë publikisht.
Dhe normal ka qenë Shoqata e Afaristëve të Sharrit "SHARRI" që e organizoj krejt këtë ngjarje që të fillon dhe përfundon kaq bukur.
I falënderoj të gjithë anëtaret e shoqatës për përkrahje të pashoqe, për kryerjen e parapërgatitjeve me shumë përkushtim deri në përfundimin e ngjarjes.
Një mirënjohje speciale për anëtarin e kryesisë z. Erol Bajrami që nuk e ka kursyer asnjë mundësi për të përmbushur çdo kriter vendi i panairit "Shkolla e Re" dhe për nënkryetarin e shoqatës z. Shpetim Kamberi që me ide dhe me shumë punën i ka menaxhuar financat dhe pjesët organizative të panairit.

Edhe njëherë e kemi treguar se edhe pse jemi vend i vogël kemi njerëz dhe produkte të perspektivës së madhe.

Zoti ju bekoftë
Kryetari shoqatës : Burim Piraj MBA-IB



EXPO SHARRI 2022
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA

*Nën organizimin e*
*Shoqatës së Afaristëve "Sharri"*
*dhe mbështetjen financiare nga Komuna e Dragashit, më 28.10.2022, në Dragash është zhvilluar aktiviteti më i madh dhe më i organizuar profesionalisht në prezantimin e bizneseve, traditës, kulturës dhe shërbimeve në komunën e Dragashit*





*Prezantimi i vlerave lokale dhe përgatitja e ushqimit tradicional, si flija, hallva dhe qebapët, kanë qenë aktivitet i cili është realizuar gjatë ditës, përpara hapësirave të hallës së panairit,*
*ku të gjithë të pranishmit dhe vizitorët kanë pasur mundësi që t'i shijojnë këto produkte, pa pagesë.*

*Hapja solemne e panairit nga ana e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, si dhe vet prezenca e tij, së bashku me kryetarin e Komunës, Bexhet Xheladini, i të shoqëruar nga kryetari i shoqatës, Burim Piraj, ka bërë që panairi të merr karakter, jo vetëm lokal, por edhe nacional.*
*Kryeministri Kurti vizitoi të gjithë ekspozuesit.*



EXPO SHARRI 2022
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA



*Panairi u karakterizua me pjesëmarrjen e një numri të kënaqshëm ekspozuesish nga, pothuajse të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë me të cilat karakterizohet komuna e Dragashit, siç janë: Produktet e qumështit, ato të mishit, ëmbëlsirat,*

## PJESËMARRJA SIPAS AKTIVITETEVE




Numri i pjesmarrësve sipas aktiviteteve




Numri i pjesmarrësve në %

- *Shërbime*
- *Turizëm*
- *Gastronomi*
- *Artizanale*
- *Media*
- *Fermerë*
- *Prodhim*
- *OJQ*



EXPO SHARRI 2022
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA



*Produktet me prejardhje direkte nga bjeshkët e Sharrit, ishin produktet që zgjuan interesim më të madh tek vizitorët në panairin EXPO SHARRI 2022.*
*Mjalti dhe bimët të cilat rriten në natyrë dhe ato që kultivohen në regjionin e bjeshkëve të Sharrit arrijnë cilësinë dhe kualitetin maksimal.*
*Këtë e dëshmon edhe Fakti se ato eksportohen Edhe në Evropë.*






## Bimët mjekuese
## Mjalti
## Djathi i Sharrit

2022
EXPO SHARRI
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA

*Komuna e Dragashit ka disa kompani që merren me aktivitete të shumta. Edhe Panairi u dallua me një laramani të aktiviteteve që zhvillohen në këtë komunë. Aktivitete kryesore, prezentë në këtë panair, ishin prodhimi i djathit, vezëve dhe brumërave*







Tabela sipas aktivitetetve

*Përveç aktiviteteve prodhuese, me produktet që karakterizojnë këtë komunë, në panair kishte edhe biznese që karakterizohen me prodhime specifike por edhe me shërbime specifike.*






Pjesëmarrja në përqindje sipas aktiviteteve

EXPO SHARRI 2022
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA




Pjesëmarrja sipas komuniteteve



*EXPO SHARRI 2022 ka mbledhur në prezantim të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Dragashit.*
*Pjesëmarrja e komunitetit nga regjioni i Gorës, si në Prezantim, si ekspozues dhe me program artistik, e ka hijeshuar diversitetin që ka kjo trevë.*
*Ekspozimi i veshjeve tradicionale të komuniteteve që jetojnë në komunën e Dragashit, i ka shtuar bukurinë këtij panairi.*
*Artizanalet dhe produktet që janë trashëgimi kulturore e kësaj treve, kanë qenë element që ka zgjuar interesim të madh.*






Pjesëmarrja në %  sipas komuniteteve

2022
EXPO SHARRI
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA

*Se në komunën e Dragashit ka edhe biznese dhe iniciativa biznesi nga gratë dhe vajzat e kësaj komune, dëshmoi pjesëmarrja mjaftë e mirë e tyre në këtë panair. Gratë dhe vajzat e kësaj treve janë perspektivë e zhvillimit ekonomik të zonës.*




Pjesëmarrja gjinore



*Prezentim dinjitoz i bizneseve që drejtohen dhe udhëheqen nga femrat në komunën e Dragashit*

*Femrat nga komunitetet që jetojn në komunën e Dragashit prezentuan veshjet tradicionale që prodhohen në këtë trevë*






Pjesëmarrja gjinore në %

*Vallet tradicionale dhe mikpritja opojane e karakterizuan pjesën artistike të këtij panairi.*
*Programi artistik nga SHKA "BRESANA" me interpretimin e valleve tradicionale*





*Traditë dhe bukuri*





*Kulturë dhe trashigimi*







*Aktiviteti para panairit, prezantimi medial dhe transmetimi i ngjarjes, direkt nga panairi, në disa kanale audiovizuele, si dhe në rrjetet sociale, ishte pika më e fortë e marketingut. Të gjitha mediat vendore si dhe të gjitha gazetat dhe portalet, kanë dhënë informacione mbi zhvillimin e kësaj ngjarje. Dy mediat lokale, Radio SHARRI dhe TV OPOJA, dhanë*















EKO Sharri

Djath me shije unike Sharri

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

HIT FLORES
organic herbs & fruits from Shari Mountains

Grumbulluesi dhe exportuesi më i madh bimëve nga natyra e Sharrit

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

radio SHARRI DRAGASH

Zëri i parë medial në Sharr

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

MEKA HALAL FOOD

Lider për produkte të mishit në Kosovë

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

Qumështore Sharri OPOJË

Shija unike e produkteve të qumështit nga bjeshkët e Sharrit

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

COLI DECOR

E bukura dhe modernja Mobileri kualitative

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

OPOJA TV CHANNEL

Mediumi i vetëm televiziv nga Komuna e Dragashit

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

ALOMETAL

Dyer dhe dritare nga plastika

Na vizitoni në panair
me 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI

NDËRMARRJA TREGËTARE ÇLIRIMI Bellobrad

*Ndërmarrja Tregtare me Shumicë dhe Pakicë, vendi ku të gjitha mallrat i gjeni në një vend!*

Na vizitoni në panair më 28.10.2022

2022 EXPO SHARRI
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE
SAJAM LOKALNIH PROIZVODA - FAIR OF LOCAL PRODUCTS

SHOQATA E AFARISTËVE SHARRI BUSINESS ASSOCIATION

2022 EXPO SHARRI
PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA






















KUVENDI KOMUNAL DRAGASH – SKUPŠTINA OPŠTINE DRAGAŠ – DRAGASH MUNICIPALITY

SHOQATA E AFARISTËVE SHARRI BUSINESS ASSOCIATION

2022

EXPO SHARRI

PANAIRI I PRODUKTEVE LOKALE - SAJAM LOKALNIH PROIZVODA

SHOQATA E AFARISTËVE SHARRI BUSINESS ASSOCIATION




*Dragash, Tetor 2022*
*Pregaditja dhe dizajni:*
SHPETIM KAMBERI